



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 21.08.2025

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 28, paragrafi 28.1 dhe nenit 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi 632-24-1744-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-021-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-8935, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, me dt.21.08.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM
Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, si pasojë e mbylljes së aktivitetit afarist për arsye personale, kontrata me numër të prokurimit 632-24-1744-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-021-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-8935, me titull "Ri tender -Furnizim me lule dhe kurora", e lidhur me dt.10.06.2024, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të furnizimeve Arbnore Hyla B.I, rr."Ismail Qemajli", Gjakovë, NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, në pajtim me nenin 28, paragrafi 28.1 dhe nenin 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për “Ri tender - Furnizim me lule dhe kurora”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të furnizimeve Arbnore Hyla B.I, rr.”Ismail Qemajli”, Gjakovë, për kryerjen e furnizimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me datë 18.08.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës.

Me datë 20.08.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për ndërprerje me marrëveshje të kontratës” të kryesit të furnizimeve Arbnore Hyla B.I, rr.”Ismail Qemajli”, Gjakovë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.


Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Punët e Përgjithshme Administrative;
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.